



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2122, date 04.07.2012

Per

“Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 04.07.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”

mori ne shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Grupi i Punes, te perbere nga:

- i. Relacioni shpjegues;
- ii. Dokumenti “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit - Dokumenti Përfundimtar*”;
- iii. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485.

BAZA LIGJORE:

- 1) Shkronja ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
- 2) Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*), i ndryshuar;
- 3) Shkronja e) e pikes 1 dhe pika 17 e nenit 21 të“Rregullores se Brendeshme te AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues te ERT-se, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe ne fuqi sipas pikës 3 te nenit 138 te ligjit nr. 9918;
- 4) “Rregullore per analizen e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, date 17.07.2009, te Keshillit Drejtues te AKEP (*Rregullorja*).
- 5) Vendim Nr.1887, datë 19.04.2012 Për “Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit - Konsultim Publik”
- 6) Vendim Nr.2118 datë 4.07.2012 Për “Miratimin e Dokumentit “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit - Dokumenti Përfundimtar*””

KESHILLI DREJTUES

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V E R E N:

1. Bazuar në VKD nr. 1211, datë 31.3.2010, të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, i ndryshuar, Vodafone Albania sh.a është shpallur sipërmarrës me FNT në tregjet përkëts të mëposhtëm:
 - a. terminimi i thirrjeve në rrjetin Vodafone Albania
 - b. akses/origjinimi i thirrjeve në rrjete celulare
2. Afati i vlefshmërisë së statusit me FNT sipas pikës 8 të VKD nr. 1211, datë 31.3.2010 është deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër nga AKEP mbi bazën e analizës së tregut te kryer sipas nenit 34 te Ligjit 9918.
3. Këshilli Drejtus i AKEP me vendimin nr. 1887, datë 19.04.2012, miratoi nxjerrjen në konsultim Publik të dokumentit “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit - Konsultim Publik*”.
4. Këshillimi publik u krye më datë 20.04.2012-20.06.2012, dhe Vodafone Albania nëpërmjet shkresës me Referencë LGD/0192/OX, datë 20.06.2012 ka dërguar komente për dokumentin e Analizës, propozimet e AKEP për FNT dhe për masat rregulluese.
5. AKEP me VKD Nr.2118 datë 4.07.2012 ka miratuar dokumentin “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit-Dokument*”

Përfundimtar”, i cili përmban edhe qëndrimet ndaj komenteve të palëve të interesuara, përfshirë komentet e Vodafone Albania.

6. Dokumenti “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit-Dokumenti Përfundimtar*” i miratuar me VKD Nr.2118 datë 4.07.2012,
 - a. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
 - b. përmban arsyetimin dhe përfundimin se Vodafone Albania sh.a përmbush kriteret për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Vodafone Albania si dhe përmban arsyetimin për masat rregulluese për FNT për terminimin e thirrjeve në rrjet celular.
 - c. përmban arsyetimin dhe përfundimin se tregu i aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjet celular nuk është më treg përkatës i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante dhe për rrjedhë Vodafone Albania nuk ka më status me FNT për këtë treg.
 - d. përmban arsyetimin për vendosjen, ndryshimin, mbajtjen dhe heqjen e detyrimeve për FNT të cilat janë në përputhje, me percaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918.

A T E H E R E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të këtij vendimi për konkurrencën në treg, sipërmarrësin dhe realizimin e objektivave rregullatore, , në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918 dhe shkronjes e) të pikes 1 dhe pikës 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendeshme, si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuar në shkronjën ç) të nenit 8 të ligjit nr. 9918, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Bazuar në dokumentin “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit-Dokumenti Përfundimtar*”, miratuar me VKD Nr.2118 datë 4.07.2012:
 - 1.1 të përcaktojë sipërmarrësin Vodafone Albania Sh.a., sipërmarrës me FNT në tregun përkatës:
 - tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të lëvizshëm të Vodafone Albania;
 - 1.2 të heqë statusin me FNT të Vodafone Albania sh.a. në tregun përkatës të mëposhtëm:
 - tregu me shumicë i akses/origjinimit i thirrjeve në rrjetet celulare.
2. Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a. i përcaktuar sipërmarrës me FNT, për shërbimin e terminimit të thirrjeve, është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet përkatëse si më poshtë, por pa u kufizuar:

- 2.1 Detyrimin e mosdiskriminimit, sipas nenit 39 të ligjit nr. 9918.
- 2.2 Detyrimin e transparencës, sipas nenit 40 të ligjit nr. 9918.
- 2.3 Detyrimi për ndarjen e llogarive, sipas nenit 41 të ligjit nr. 9918.
- 2.4 Detyrimin për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit, sipas nenit 42 të ligjit nr. 9918.
- 2.5 Detyrimin për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9918.

3. Detyrimet e mësipërme në pikën 3, përfshijnë midis të tjerave:

3.1 Detyrimi i Mosdiskriminimit:

- i) Sipermarrësi Vodafone Albania Sh.a., të zbatojë kushte të njëjta, në rrethana të njëjta ndaj sipermarrësve të tjerë, që ofrojnë shërbime ekuivalente, si dhe t'u ofrojnë sipermarrësve të tjerë shërbime dhe informacion në kushte të njëjta dhe me cilësi të njëjtë, sikundër ai i ofron për shërbimet e veta, për filialet ose partnerët e tij
- ii) Sipermarrësi Vodafone Albania Sh.a., të përditësojë Ofertën Referencë të Interkoneksionit, për ta pershtatur me ndryshimet dhe nevojat e tregut, brenda 45 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;
- iii) Sipermarrësi Vodafone Albania Sh.a., të publikojë marrëveshje të Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement-SLA) si dhe Tregues Kryesore të Performancës (Key Performance Indicators -KPI) për interkoneksionin sipas përcaktimeve të Rregullores së Akses dhe Interkoneksionit.

3.2 Detyrimi i transparencës:

Oferta Referencë e Interkoneksionit e përditësuar nga Vodafone Albania duhet të përshijë informacionin e mëposhtëm të nevojshme për interkoneksion me Vodafone Albania:

- a) Specifikimet teknike;
- b) Karakteristikat e rrjetit;
- c) Termat dhe kushtet për ofrimin dhe përdorimin;
- ç) Tarifat, përfshirë zbritjet e mundshme.

3.3 Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit:

Sipermarrësi Vodafone Albania Sh.a., për terminimin e thirrjeve në rrjetin celular, duhet:

- a) t'u ofrojnë palëve të treta akses dhe interkoneksion në rrjet dhe elementet e tij;
- b) të ofrojnë shërbime të veçanta në nivel shumice, për t'u rishitur nga palet e treta;
- c) të mos anulojë aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;
- ç) të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;

d) te ofroje akses te hapur ne nderfaqet teknike, protokollet ose teknologjite e tjera te rendesishme, te domosdoshme per nderveprimin e sherbimeve ose per sherbimet e rrjetit virtual;

dh) te ofroje bashkevendosje ose forma te tjera te perdorimit te perbashket, perfshire ndertesat, tubacionet kabllore ose shtyllat, kullat;

e) te krijoje kushtet e nevojshme per te siguruar nderveprimin e sherbimeve pike fundore – pike fundore, duke perfshirë facilitetet per sherbimet e rrjetit inteligjent dhe/ose roaming-ut ne rrjetet mobile;

ë) te ofroje akses ne sistemet mbeshtetese funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (softëare), te nevojshme, per te siguruar konkurrence te ndershme ne ofrimin e sherbimeve;

f) te interkonektoje rrjetet ose facilitetet e rrjetit.

Për gërmat d), dh), e), ë), të mësipërme, detyrimi për akses i referohet vetëm për mundësimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Vodafone Albania, dhe janë të zbatueshme sipas mundësive/aftësive teknike dhe ekonomike të sipermarresit Vodafone Albania Sh.a, si edhe me tarifa te cilat mbajnë parasysh investimet e kryera dhe një normë të arsyeshme fitimi.

3.4 Detyrimi për ndarjen e llogarive dhe detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive:

i) Tarifa e terminimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me terminimin e thirrjeve në rrjetin Vodafone Albania janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP.

ii) Në përputhje me nenin 57, pika 1 gërma ‘a’, Vlerat maksimale të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të Vodafone Albania, për t’u aplikuar nga Vodafone Albania sh.a të jenë sipas vlerave dhe afateve të përcaktuar në Tabelën 1, Aneks 1 të VKD nr. 1507 datë 10.02.2011.

iii) Zbatimi i detyrimit të ndarjes se llogarive dhe mbajtjes së llogarive (nenet 41 dhe 45) dhe zbatimi i detyrimit të orientimit ne kosto te tarifave te interkoneksionit (neni 59), nga Vodafone Albania, do te kryhet ne baze te percaktimeve te mevonshme te AKEP.

4. Sipermarrësi Vodafone Albania Sh.a. ka detyrimin që të zbatojë detyrime dhe specifikime të tjera të përcaktuara nga AKEP, sipas nevojave te tregut, per statusin e FNT në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve.

5. Afati i vlefshmërisë së statusit me FNT për sipermarrësin Vodafone Albania Sh.a. në tregun përkatës referuar në pikën 1.1 të këtij vendimi., është deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër nga AKEP mbi bazën e analizës së tregut te kryer sipas nenit 34 te Ligjit 9918.

6. Në përputhje me nenin 34 te ligjit 9918 dhe pikën 5 të nenit 3 të Rregullores për Analizën e Tregut:

6.1 Detyrimet e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. për tregun *me shumicë të akses/origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare (Tregu nr.17 në Rregullore), përcaktuar në* vendimin nr.1211, date 31.03.2010 të Keshillit Drejtues të AKEP, *hiqen.*

6.2 *Heqja e detyrimeve te cituar ne piken 6.1 me siper bëhet efektive me 1.01.2013.*

6.3 *Detyrimet e* Vodafone Albania sh.a. për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të përcaktuara në vendimin nr.1211, date 31.03.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP, dhe amendimet e tij, *hiqen.*

6.4 *Heqja e detyrimeve te cituar ne piken 6.3 më sipër bëhet efektive më 1.09.2012.*

7. Vendimi nr.1211, date 31.03.2010 i Keshillit Drejtues të AKEP shfuqizohet.
8. Kundra ketij vendimi, mund të bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit përkatës.
9. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE